



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA"

UNIVERSITY "KADRI ZEKA"

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë

www.upgj.org tel: 0280390112

Ref. nr. 01/1474 Dt.09.12.2015

Duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 paragrafi 3, pika 3.5, dhe nenit 13 paragrafi 2 pika 2.3 të Ligjit për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës, si dhe dispozitat e nenit 48 paragrafi 1, pika 1.3 dhe të nenit 161 pika 1 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit, Senati i këtij Universiteti në takimin e mbajtur më 03.12.2015, miratoi këtë:

Rregullore për zgjedhjen e personelit akademik në Universitetin "Kadri Zeqa" në Gjilan

I. Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Kjo Rregullore i përcakton kushtet e Përgjithshme për zgjedhjen e personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune të bazuara në Ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e Universitetit si dhe kriteret e veçanta për zgjedhjen e personelit akademik të nxjerra nga Senati i Universitetit.

Neni 2

Profesorët e rregullt, profesorët e asocuar dhe profesorët asistent duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë një sfond të sukseshëm të mësimdhënies, hulumtimit dhe të praktikës profesionale apo artistike.

Neni 3

Universiteti siguron dhe mbështet barazinë gjinore. Në rastet kur kandidatët e gjinisë mashkullore dhe femërore i kanë kualifikimet e njëjta, përparësi do t'i jepet kandidates femër.

Neni 4

Vendimin për shpallje të konkursit për zgjedhje apo rizgjedhje të personelit akademik e merr senati i universitetit sipas propozimit të njësive akademike. Konkursi zgjatë 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes. Vendimi për për shpallje të konkursit për rizgjedhje duhet të miratohet nga senati 6 muaj para kalimit të kohës për të cilën janë zgjedhur. Konkursi publik duhet të shpallet përmes mjeteve të informimit së paku në tre gazeta ditore dhe në ueb-faqen e Universitetit. Konkursi duhet të përmbajë lëmin shkencor në të cilin zgjidhet kandidati, afatin dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për zgjedhje.

Neni 5

Kandidatët që i kanë kryer studimet bachelor, master, magjistraturë dhe doktoraturë - jashtë vendit, duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Neni 6

Për vlerësimin e kandidatëve formohet komisioni recensues. Komisionin recensues e formon Fakulteti apo Senati jo më vonë se 30 ditë nga dita e shpalljes së konkursit. Dekani në afat prej 8 ditëve i lajmeron formalisht anëtarët e komisionit recensues për formimin dhe përbëjen e tij. Komisioni recensues përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë. Anëtarët e komisionit recensues mund të jenë intern ose ekstern (nga universitete tjera në vend dhe jashtë vendit). Anëtarët e komisionit recensues nuk mund të jenë me thirrje më të ulët se thirrja për të cilën konkurron dhe zgjidhet kandidati. Anëtarë të komisionit recensues mund të jenë edhe personat e pensionuar me thirrje shkencore (professor i rregullt dhe i asocuar), por jo edhe ata të cilët e kanë kaluar moshën 70 vjeçare.

Neni 7

Komisioni recensues shkruan referatin, mbush formularët, evaluon të dhënat dhe i dorëzon referat të shkruar njësisë akademike, për të gjithë kandidatët e paraqitur. Komisioni recensues mund të vendosë për intervistim të kandidatëve dhe veçanërisht kur dy ose më tepër kandidatë kanë të arritura të ngjashme.

Neni 8

Referati i komisionit recensues përmban:

- Të dhënat për kandidatin;
- Të dhënat tjera për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe vlerësimin në bazë të kriterëve të veçanta sipas kësaj rregullore.

Në fund të Referatit qëndron propozimi për zgjedhje të kandidatit më të mirë ose për mos zgjedhje të asnjë kandidati. Propozimi për zgjedhje i elaboron arsyet për këtë propozim si dhe konstatimet për secilin kandidat që nuk është propozuar.

Komisioni recensues dorëzon raportin e tij njësisë akademike, brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të dokumenteve.

Nëse ndonjë anëtar i Komisionit recensues ka një mendim të ndryshëm në lidhje me propozimin për promovimin e kandidatit, atëherë ai anëtar është i inkurajuar që të paraqesë një „raport të veçantë” për strukturat menaxhuese të Fakultetit apo të Universitetit. Kjo duhet të jetë një raport i plotë në përputhje me kërkesat e detajuara këtu. Në raste të tilla, dekani do të paraqesë të dy raportet në Këshill të Fakultetit apo Senat të Universitetit.

Fakulteti apo Senati i Universitytit mban të drejtën të pranojë njërin, të refuzojë të dy raportet, por nuk mund të miratojë të dy për të njëjtën pozitë.

Universiteti, nëpërmjet Zyrës së burimeve njerëzore e publikon Referatin e komisionit recensues.

Nëse Fakulteti e miraton propozimin e komisionit, raporti dërgohet në Komision të studimeve për verifikim dhe më pastaj komisioni i studimeve i propozon Senatit për vendimarrje. Nëse Fakulteti nuk e miraton raportin, procedura mbaron këtu, kurse konkursi mund të rishpallet për atë pozitë.

Buletini i universitetit ku publikohen të gjitha raportet që shqyrtohen në Senat botohet të paktën 15 ditë para mbledhjes së Senatit, respektivisht pas propozimit të komisionit të studimeve.

Neni 9

Gjatë procesit të vlerësimit kandidatët i nënshtrohen prezantimit provues – vlerësues. Në cilësinë e vlerësuesit përveç anëtarëve të komisionit vlerësues do të asistojë së paku edhe një anëtarë nga stafi menaxhues i Fakultetit apo Universitetit.

Neni 10

I gjithë personeli akademik gjatë periudhës së udhëhequr nga organet e përkohshme pas përfundimit të procedurave të rregullta do të emërohet nga Rektori dhe Këshilli i Përkohshëm Drejtues në bashkëpunim me MASHT, sipas vendimit të Senatit i bazuar në propozimin e njesisë akademike.

Neni 11

1. Në stafin akademik të Universitetit do të punësohen apo angazhohen personat në:
 - Mësimdhënie akademike;
 - Kërkime shkencore;
 - Krijimtari artistike.

2. Personeli akademik përbëhet nga:
 - Profesorët e rregullt (Prof.Dr.);
 - Profesorët e asocuar (Prof.Asoc.Dr.);
 - Profesor asistentë (Prof.Ass.Dr.)
 - Ligjërues (i angazhuar);
 - Asistent universiteti (Ass.).
 - Lektorët dhe korepetitorët (Fakulteti i Arteve).

Neni 12

Kushtet për emërimin dhe avancimin e çfarëdo titulli të personelit akademik janë kualifikimet përkatëse dhe përvoja relevante për vendin e punës.

Kushtet e përgjithshme - Profesor i rregullt

Neni 13

1. Për titullin e profesorit të rregullt të njësisë akademike, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:

- Të ketë gradën e doktorit të shkencës dhe thirrjen e profesorit të asocuar (ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve);
 - Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me:
 - Një numër të rëndësishëm të monografive, teksteve mësimore, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me më së paku 5 punime kryesore të publikuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare;
 - Pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - Krijime ose punime të njohura artistike ose të ketë pasur prezentime publike dhe të ketë kontribuar kur është rasti i Fakultetit të Arteve; në mënyrë të veçantë duhet të ketë kontribuar në zhvillimin e kulturës dhe të artit;
 - Përvojë afatgjate në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme;
 - Aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjik përmes praktikës së arsyeshme;
 - Aftësi për udhëheqje akademike;
 - Udhëheqje të temave master dhe të doktoratës.
3. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen për kohë të pacaktuar.

Kriteret e veçanta- Profesor i rregullt

Neni 14

Pikët e vlerësimit sipas kategorive për profesor i rregullt:

Profesorët	Pikët
1. Bachelor	3 deri 15 pikë
2. Master	3 deri 15 pikë
3. Prezentimi provues	0 deri 20 pikë
4. Gjuhët e huaja	0 deri 13 pikë
5. Punimet	0 deri 30 pikë
6. Përvoja	0 deri 7 pikë

Pika 1: Bachelor dhe Master

Notat	Bachelor	Master	PhD	Pikët (Totali)
Nota 6 deri ne 7	3	3		
Nota 7 deri ne 7.50	5	5		
Nota 7.5 deri ne 8	7	7		
Nota 8 deri ne 8.5	9	9		
Nota 8.5 deri ne 9	11	11		
Nota 9 deri ne 9.5	13	13		
Nota 9.5 deri ne 10	15	15		

Në rast se kandidati i ka të kryer studimet themelore 4 vjeçare dhe ka vazhduar në studimet e doktoratës, atëherë vlerësimi i poenave të masterit llogaritet me sa vijon:

- Nëse ekziston nota mesatare në PhD, mblidhet me notën mesatare të studimeve themelore dhe pjestohet për 2.
- Nëse nuk ka notë mesatare në PhD, atëherë zbatohet nota mesatare e studimeve themelore

Në raste kur nuk specifikohet nota mesatare në PhD, komisioni recensues bënë vlerësimin dhe cakton poentimin në bazë të fushës së studimeve si dhe pozitës për të cilën konkuron kandidati apo kandidatja.

Pika 2: Prezentimi provues

Prezentimi provues	0 deri në 20 pikë
--------------------	-------------------

Vlerësimi i prezentimit provues behet nga anëtarët e komisionit recensues dhe së paku nga një përfaqesues i Fakultetit apo Universitetit.

Pika 3: Gjuhët e Huaja

		Pikët (Totali) 13 pikë
Gjuhë e huaj	Gjuhë angleze, gjermane, frenge	0-6
	Gjuhë rajonale (sllave, turke, greke etj.)	0-4
	Gjuhë të tjera	0-3

Nëse komisioni nuk ka njohuri të mjaftueshme për vlerësim, atëherë kërkohen dokumente shtesë kredibile që dëshmojnë njohuritë nga gjuhët e huaja apo caktohet personi kompetent për vlerësim.

Pika 4: Punimet

		Pikët (Totali) 30 pikë
Punimet Shkencore	Monografi shkencore	0-9
	Punime në revista ndërkombëtare	0-8
	Punime në revista Rajonale (Shqipëria, Maqedonia, Mali i zi, Serbia)	0-4
	Punime në Revista Kosovare	0-2
	Prezantimet në Konferenca	0-3
	Botimet Universitare	0-4

Pika 5: Përvoja

		Pikët (Totali) 7 pikë
Përvoja e punës	1. Në mësimdhënie	0-5
	2. Profesione tjera të lidhura me fushën e mësimdhënies.	0-2

Shënim: Nëse asnjëri nga kandidatët nuk i arrijnë 61 pikë, konkursi për atë pozitë përsëritet.

Neni 15

Kushtet e përgjithshme- Profesor i asocuar

1. Për titullin e profesorit të asocuar kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë thirrjen e doktorit të shkencës dhe thirrjen akademike profesor asistent (ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve);
- Të ketë një numër të zgjedhur të monografive, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, me së paku 3 punime kryesore të publikuara në revista ndërkombëtare;
- Të ketë krijuar punime të vërteta artistike ose të ketë pasur prezentime publike, kur është rasti për Fakultetin e Arteve
- Të tregojë aftësi për mësimdhënie;
- Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri, në lëndën e fushës përkatëse.

2. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit është për 4 vite.

Kriteret e veçanta- Profesor i Asocuar

Neni 16

Pikët e vlerësimit sipas kategorive për profesor i asocuar:

Profesorët	Pikët
7. Bachelor	3 deri 15 pikë
8. Master	3 deri 15 pikë
9. Prezentimi provues	0 deri 20 pikë
10. Gjuhët e huaja	0 deri 13 pikë
11. Punimet	0 deri 30 pikë
12. Përvoja	0 deri 7 pikë

Pika 1: Bachelor dhe Master

Notat	Bachelor	Master	PhD	Pikët (Totali)
Nota 6 deri ne 7	3	3		
Nota 7 deri ne 7.50	5	5		
Nota 7.5 deri ne 8	7	7		
Nota 8 deri ne 8.5	9	9		
Nota 8.5 deri ne 9	11	11		
Nota 9 deri ne 9.5	13	13		
Nota 9.5 deri ne 10	15	15		

Në rast se kandidati i ka të kryer studimet themelore 4 vjeçare dhe ka vazhduar në studimet e doktoratës, atëherë vlerësimi i poenave të masterit llogaritet me sa vijon:

- c) Nëse ekziston nota mesatare në PhD, mblidhet me notën mesatare të studimeve themelore dhe pjestohet për 2.
- d) Nëse nuk ka notë mesatare në PhD, atëherë zbatohet nota mesatare e studimeve themelore

Në raste kur nuk specifikohet nota mesatare në PhD, komisioni recensues bënë vlerësimin dhe cakton poentimin në bazë të fushës së studimeve si dhe pozitës për të cilën konkuron kandidati apo kandidatja.

Pika 2: Prezentimi provues

Prezentimi provues	0 deri në 20 pikë
--------------------	-------------------

Vlerësimi i prezentimit provues behet nga anëtarët e komisionit recensues dhe së paku nga një përfaqesues i Fakultetit apo Universitetit.

Pika 3: Gjuhët e Huaja

		Pikët (Totali) 13 pikë
Gjuhë e huaj	Gjuhë angleze, gjermane, frenge	0-6
	Gjuhë rajonale (sllave, turke, greke etj.)	0-4
	Gjuhë të tjera	0-3

Nëse komisioni nuk ka njohuri të mjaftueshme për vlerësim, atëherë kërkohen dokumente shitesë kredibile që dëshmojnë njohuritë nga gjuhët e huaja apo caktohet personi kompetent për vlerësim.

Pika 4: Punimet

		Pikët (Totali) 30 pikë
Punimet Shkencore	Monografi shkencore	0-9
	Punime në revista ndërkombëtare	0-8
	Punime në revista Rajonale (Shqipëria, Maqedonia, Mali i zi, Serbia)	0-4
	Punime në Revista Kosovare	0-2
	Prezantimet ne Konferenca	0-3
	Botimet Universitare	0-4

Pika 5: Përvoja

		Pikët (Totali) 7 pikë
Përvoja e punës	1. Në mësimdhënie	0-5
	2. Profesione tjera të lidhura me fushën e mësimdhënies.	0-2

Shënim: Nëse asnjëri nga kandidatët nuk i arrijnë 61 pikë, konkursi për atë pozitë përsëritet.

Kushtet e përgjithshme- Profesor i asistent

Neni 17

1. Për titullin e profesorit asistent kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë gradën e doktorit të shkencës, (në Fakultetin e Arteve ekuivalente me të);
- Të ketë numër të zgjedhur të monografive dhe publikimeve të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me së paku një punim kryesor të publikuar dhe të shqyrtuar në revista ndërkombëtare;
- Të ketë krijuar punime artistike ose të ketë pasur prezente publike, kur është fjala për Fakultetin e Arteve;
- Të tregojë aftësi për mësimdhënie.
- Të ketë së paku tri vite përvojë pune në procesin mësimor në Universitetet.

2. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit është për 4 vite.

Kriteret e veçanta- Profesor i Asistent

Neni 18

Pikët e vlerësimit sipas kategorive për profesor i asocuar:

Profesorët	Pikët
13. Bachelor	3 deri 15 pikë
14. Master	3 deri 15 pikë
15. Prezentimi provues	0 deri 20 pikë
16. Gjuhët e huaja	0 deri 13 pikë
17. Punimet	0 deri 30 pikë
18. Përvoja	0 deri 7 pikë

Pika 1: Bachelor, Master dhe PhD

Notat	Bachelor	Master	PhD	Pikët (Totali)
Nota 6 deri ne 7	3	3		
Nota 7 deri ne 7.50	5	5		
Nota 7.5 deri ne 8	7	7		
Nota 8 deri ne 8.5	9	9		
Nota 8.5 deri ne 9	11	11		
Nota 9 deri ne 9.5	13	13		
Nota 9.5 deri ne 10	15	15		

Në rast se kandidati i ka të kryer studimet themelore 4 vjeçare dhe ka vazhduar në studimet e doktoratës, atëherë vlerësimi i poenave të masterit llogaritet me sa vijon:

- e) Nëse ekziston nota mesatare në PhD, mblidhet me notën mesatare të studimeve themelore dhe pjestohet për 2.
- f) Nëse nuk ka notë mesatare në PhD, atëherë zbatohet nota mesatare e studimeve themelore

Në raste kur nuk specifikohet nota mesatare në PhD, komisioni recensues bënë vlerësimin dhe cakton poentimin në bazë të fushës së studimeve si dhe pozitës për të cilën konkurron kandidati apo kandidatja.

Pika 2: Prezentimi provues

Prezentimi provues	0 deri në 20 pikë
--------------------	-------------------

Vlerësimi i prezentimit provues behet nga anëtarët e komisionit recensues dhe së paku nga një përfaqesues i Fakultetit apo Universitetit.

Pika 3: Gjuhët e Huaja

		Pikët (Totali) 13 pikë
Gjuhë e huaj	Gjuhë angleze, gjermane, frënge	0-6
	Gjuhë rajonale (sllave, turke, greke etj.)	0-4
	Gjuhë të tjera	0-3

Nëse komisioni nuk ka njohuri të mjaftueshme për vlerësim, atëherë kërkohen dokumente shtesë kredibile që dëshmojnë njohuritë nga gjuhët e huaja apo caktohet personi kompetent për vlerësim.

Pika 4: Punimet

		Pikët (Totali) 30 pikë
Punimet Shkencore	Monografi shkencore	0-9
	Punime në revista ndërkombëtare	0-8
	Punime në revista Rajonale (Shqipëria, Maqedonia, Mali i zi, Serbia)	0-4
	Punime në Revista Kosovare	0-2
	Prezantimet në Konferenca	0-3
	Botimet Universitare	0-4

Pika 5: Përvoja

		Pikët (Totali) 7 pikë
Përvoja e punës	1. Në mësimdhënie	0-5
	2. Profesione tjera të lidhura me fushën e mësimdhënies.	0-2

Shënim: Nëse asnjëri nga kandidatët nuk i arrijnë 61 pikë, konkursi për atë pozitë përsëritet.

Kushtet e përgjithshme – Asistent

Neni 19

1. Për titullin e asistentit kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë të përfunduar me sukses studimet Master në drejtimin përkatës;
- Të jetë jo më i vjetër se 30 vjet kur emërohet për herë të parë;
- Të jetë i regjistruar në studimet e doktoratës në Universitet me rastin e rizgjedhjes;

2. Të ketë notën mesatare në studimet bachelor dhe master jo më pak se 8.
3. Të gjitha emërimet si dhe kohëzgjatja e punësimit zgjat 3 vite.
4. Asistentët mbajnë orët e ushtrimeve në studimet bachelor dhe master.
5. Përgjatimisht asistenti që është rizgjedhur, në mungesë të profesorit për lëndën mund të autorizohet për mbajtjen e ligjëratave të kufizuara në studimet bachelor me autorizimin e këshillit të njësisë akademike dhe nën mbikëqyrjen e një mësimitdhënësi nga departamenti - katedra.

Neni 20

Kriteret e veçanta- Asistent

Asistentët	Pikët
1. Bachelor	15 deri 30 pikë
2. Master	15 deri 30 pikë
3. Prezantimi vleresues	0 deri 30 pikë
4. Gjuhët e huaja	0 deri 10 pikë

Pika 1: Bachelor dhe master

Notat	Bachelor	Master	Pikët (Totali)
Nota 8 deri ne 8.5	15	15	
Nota 8.5 deri ne 9	20	20	
Nota 9 deri ne 9.5	25	25	
Nota 9.5 deri ne 10	30	30	

Shënim: Nëse ndonjëri nga kandidatët ka notën mesatare nën 8 në njëren nga nivelet e studimeve, atëhere, nota mesatare nga dy nivelet (bachelor dhe master) mbledhet dhe përpjestohet me 2 dhe përdoret në poentim. Si rrjedhojë, mesatarja mbi 8 përdoret për poentim, përndryshe nëse mesatarja është nën notën 8 nga mbledhja e notave mesatare nga dy nivelet, kandidatët eliminoheën.

Pika 3: Prezantimi provues

Prezantimi provues	0 deri në 30 pikë
--------------------	-------------------

Shënim: Vlerësimi i prezentimit provues bëhet nga anëtarët e komisionit recensues dhe së paku nga një përfaqësues i Fakultetit apo Universitetit.

Pika 4: Gjuhët e Huaja

		Pikët (Totali) 10 pikë
Gjuhë e huaj	Gjuhë angleze, gjermane, frënge	0-4
	Gjuhë rajonale (sllave, turke, greke etj.)	0-3
	Gjuhë të tjera	0-3

Shënim: Nëse asnjëri nga kandidatët nuk i arrijnë 61 pikë, konkursi për atë pozitë përsëritet.

Neni 20

1. Për titullin e lektorit të gjuhëve të huaja, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë të përfunduar me sukses studimet master në gjuhën e zgjedhur;
- Të ketë aftësi të shkëlqyeshme të gjuhës së zgjedhur;
- Të ketë notën mesatare të studimeve bachelor dhe master jo më pak se 8, në secilën prej këtyre studimeve.

2. Lektorët në fakultetet e tjera pos në fakultetin amë i kanë të gjitha të drejtat dhe obligimet për mbajtjen e ligjëratave.

3. Për titullin e Korepetitorit, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë të përfunduar me sukses studimet Master, drejtimi i pianos ose ndonjë instrumenti tjetër;
- Të ketë notë mesatare jo më pak se 8, në secilën prej këtyre studimeve;

4. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit janë për 3 vite.

Gjilan, nëntor 2015



REKTORI
Prof. Assoc. Dr. Bajram Kosumi



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë

www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

Rektori: Prof.Asoc.Dr. Bajram Kosumi

Ref.nr. 01/451 dt. 11/12/2015

Senati i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, në mbledhjen e V –të mbajtur më 03.12.2015, ,
mori:

V E N D I M

Mbi plotësimin e Rregullores për zgjedhjen e personelit akademik në Universitetin "Kadri Zeka"
në Gjilan.

- I. Neni 8, paragrafi 7 i Rregullores për zgjedhjen e personelit akademik ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

"Raporti i Komisionit Recenzues i dërgohet Komisionit të Studimeve për verifikim dhe më pastaj Komisioni i studimeve i propozon Senatit për vendim-marrje. Nëse Senati nuk e miraton raportin procedura mbaron këtu, kurse konkursi mund të rishpallet për atë pozitë.

- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe do të zbatohet vetëm për konkursin e datës
05.11.2015

Vendimi t'i dorëzohet:

- Komisioneve Recenzuese
- Sekretarit të Përgjithshëm të UKZ
- Arkivit



Rektori
Prof.Asoc.Dr. Bajram Kosumi

